Republika e Shqipërisë
Ministria e Integrimit

Support to the Albanian
Ministry of European Integration



Si të kërkojmë ...

Informacion për BE-në

Federal Ministry
for Economic Cooperation
and Development

Projekt i financuar nga
Bashkimi Europian (IPA 2008) dhe Qeveria Gjermane

Projekt i zbatuar nga
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH.



"SI TË KËRKOJMË ... "

INFORMACION PËR BE-në

PËRMBLEDHJE E UDHËZUESVE "SI TË..."

1. përdorim Fletoren Zyrtare
2. gjejmë një direktivë
3. gjejmë dokumentet e Komisionit
4. gjejmë jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian (GJDBE)
5. gjejmë masat zbatuese kombëtare
6. përdorim regjistrat e institucioneve
7. marrim informacion për fondet e BE-së
8. marrim informacion për kontratat dhe tenderat e BE-së
9. gjejmë statistikat e BE-së
10. mbledhim informacion kërkimor për BE-në (udhëzues për studentë)
11. qëndrojmë të përditësuar për BE-në

SI TË PËRDORIM FLETOREN ZYRTARE

1. PËRMBAJTJA

Ashtu siç e tregon edhe titulli, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian (OJEU ose OJ) është edicioni i publikimeve zyrtare të Bashkimit Europian. Në format e saj të ndryshme, ajo përmban tekstet e legjislacionit të miratuar, detaje të shkurtra çështjesh dhe aktgjykimesh nga Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme, ftesa për të marrë pjesë në tender për kontrata publike dhe për të konkurruar për fonde të BE-së si dhe një shumëllojshmëri njoftimesh dhe komunikatash nga Komisioni Europian.

2. CITIME

2. Citime
Fletorja Zyrtare botohet zakonisht pesë ditë në javë, nga e marta në të shtunën, dhe me raste botohet dhe të hënën.
Çdo numër ka numrin e vet dhe çdo seri ka numrin e vet rendor, numërim i cili fillon rishtazi çdo vit.
Në mënyrë që të gjendet një numër i caktuar kërkohet viti, seria dhe numri i Fletores.
Këto referenca ose citime për Fletoren Zyrtare jepen në mënyrë standarde. Tabela në faqen në vijim jep disa shembuj.
Kini parasysh se botimet e Fletores Zyrtare ndonjëherë dalin me numër jashtë rendit kronologjik.

3. SERITË

Fletorja Zyrtare ndahet në tri seri: seria L, C dhe S.

Seria C ka dy numra nënserish: E dhe A. Si rezultat, është e mundur që i njëjti numër të përdoret për të trija rastet, si në rastin e C286 të datës 6 nëntor 2008, ku ka dhe C233A dhe një C233E (Shih faqen OJ 2008).

OJ CE është vetëm në versionin elektronik që del jo rregullisht dhe është burim për pyetjet me shkrim të Parlamentit Europian dhe Qëndrimet e Përbashkëta të Këshillit. Më parë, kjo ka përfshirë dhe propozime legjislacioni që botoheshin në Fletoren Zyrtare C, por tani këto propozime botohen elektronikisht si Dokumente COM (COM Documents).

Fletorja Zyrtare CA jep kryesisht detaje të konkurseve të hapura për vendet e lira në personelin e institucioneve të ndryshme të Bashkimit Europian; edhe ajo botohet jo rregullisht.

Në tetor të vitit 2008, lista e Fletoreve Zyrtare për EUR-Lex-in përfshiu numrin e parë të një edicioni të posaçëm të fletores zyrtare në gjuhën malteze, që mbante etiketën "LM"

4. SI TA GJEJMË INFORMACIONIN

Këto janë pyetjet kryesore të cilat duhet t'ia bëni vetes kur keni të bëni me një citim të Fletores Zyrtare:

Cila seri?

Cili numër edicioni? Cili vit?

Cili numër faqeje?

Versionet e shtypura të Fletores Zyrtare dalin ende dhe kanë vlerë ligjore, por pjesa më e madhe e njerëzve tani e lexojnë nëpërmjet EUR-Lex-it.

Numrat më të fundit mund të merren në faqen kryesore të EUR-Lex-it (sipër, nga ana e djathtë), por në faqen e internetit të Fletores Zyrtare (Official Journal) mund të gjenden si numrat aktualë dhe ata të mëparshëm.

Në vitet 2007, 2008 dhe 2009 mesatarisht kanë dalë 352 Fletore Zyrtare "L" dhe 324 Fletore Zyrtare "C" çdo vit

Në tetor 2009, disa numra të përzgjedhur të serive L dhe C u ofruan si skedarë "Botim i plotë" në format PDF. Kjo nismë tani mbulon të gjithë numrat e serive L dhe C, ku përdoruesit mund të zgjedhin versionet në format PDF të artikujve të veçantë ose të numrave të plotë nga faqja përkatëse në EUR-Lex (për shembull, shih Fletoren Zyrtare L254, e datës 29 shtator 2010).

Nga data 1 janar 2010, struktura e Fletoreve Zyrtare të serive L dhe C ka ndryshuar për të pasqyruar hyrjen në fuqi të Traktatit të Lisbonës (më shumë hollësi jepen në Struktura e Traktatit të Lisbonës).

Seritë	Përmbajtja	Komente	Citimi
L	Legjislacioni i miratuar dhe detajet e marrëveshjeve ndërkombëtare, konventave, etj. që hynë në fuqi	Pjesa më e rëndësishme e Fletores Zyrtare. Është e ndarë sipas elementeve "të lehta" (kryesisht, rregullore të bujqësisë dhe "të forta" (Direktiva, Rregullore dhe Vendime për të cilat janë të interesuar pjesa më e madhe e njerëzve)	OJ L 266, 26.9.2006, f1 Shënim: Kjo është Direktiva 2006/66/EC ... e datës 6 shtator 2006 për bateritë dhe akumulatorët dhe mbetjet e baterive dhe akumulatorëve
C	Detaje të shkurtra të masave të GJED-së dhe të GJSHP-së, njoftime të Komisionit në lidhje me tregtinë dhe ndihmën shtetërore, procesverbalet e Parlamentit Europian, opinionet e Komitetit të Rajoneve, Komitetit Ekonomik dhe Social dhe Gjykatës së Audituesve dhe Thirrje për Propozime për programe rifinancuese (në veçanti kërkim & zhvillim)	Përmbajtjet e këtyre serive ndryshojnë shumë. Njoftimet variojnë nga detaje rutinë mbi ndihmën shtetërore deri në njoftimet për financim, dhe në "Komunikatën e Komisionit … që lidhet me pajisjet elektronike të projektuara për t'u përdorur brenda disa kufijve të caktuara të tensionit"), prej 89 faqesh (OJ C, 208, 30.08.06)	OJ C 233, 2006, f9 Shënim: Duke qenë se çdo botim brenda OJC-së ka numrin e saj të referencës, përdoret dhe formatimi 2006/C233/06, ku '06' përfaqëson numrin e botimit jo numrin e faqes (të dyja këto citime i referohen të njëjtit botim)
CE	Pyetjet dhe përgjigjet me shkrim të Parlamentit Europian dhe Qëndrimet e Përbashkëta të Këshillit	Gjendet online nëpërmjet EUR-Lex-it dhe në CD-ROM-e. Filloi të dalë në gusht të vitit 1999	OJ 2006/C233E fq.25 ose OJ C233E, 2006, fq.25
CA	Konkurse të hapura për vendet e lira në institucionet e BE-se	Komisioni ka vendosur të përdorë edhe seritë A për të botuar Katalogun e Përbashkët të Varieteteve të Specieve të Bimëve Bujqësore, çka të ngatërron disi (shih 2008/C297A, për shembull)	OJ 2009/C9A f1
S	Ftesa për të marrë pjesë në tender për kontrata publike	Ndonjëherë quhet "suplement", "OJS", apo mund të dëgjoni ta quajnë"OJEC", pavarësisht nga fakti që tani është OJEU	2006/S 186-198010 Shënim: Kjo është OJ S 186 e vitit 2006, dokumenti numër 198010 (OJ S në versionin e shkruar nuk ka dalë më që prej vitit 1996; tani mund të gjendet online si "E përditshmja elektronike e tenderave" (Tenders Electronic Daily) si dhe në CD-ROM-e – shihni detajet)

SI TË GJEJMË NJË DIREKTIVË

1. ÇFARË ËSHTË DIREKTIVA

Direktiva është një lloj i veçantë i legjislacionit dytësor e miratuar nga institucionet e BE-së në bazë të kompetencave që u japin traktatet themeluese.

Sipas Nenit 288 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian TFEU:

Direktiva është e detyrueshme, në lidhje me rezultatin që duhet arritur, për çdo shtet anëtar të cilit i drejtohet, por ua lë autoriteteve kombëtare kompetencën e përzgjedhjes së formës dhe të mënyrave.

Kur kërkohet një direktivë, është e rëndësishme të dihet nëse kërkohet teksti origjinal në nivelin e BE-së, apo një version kombëtar i zbatuar nga një shtet anëtar.

Kur kërkohet një direktivë, është e rëndësishme të dihet nëse kërkohet teksti origjinal në nivelin e BE-së, apo një version kombëtar i zbatuar nga një shtet anëtar.

Në Mbretërinë e Bashkuar, direktivat zbatohen me një akt, ose, më shpesh, me anë të një instrumenti ligjor. Në tekstin e çdo direktive përcaktohet afati kohor për marrjen e masave zbatuese kombëtare, që është në përgjithësi dy ose tre vjet.

2. KU BOTOHET DIREKTIVA

Direktivat botohen në seritë L (Legislation) të Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian (Official Journal of the European Union), që është e disponueshme në versionin e shtypur, por që në përgjithësi tani shikohet online nëpërmjet bazës së të dhënave EUR-Lex-it.

3. SI TA CITOJMË NJË DIREKTIVË

Direktiva 2006/44/EC e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 6 shtator 2006, për cilësinë e ujërave të ëmbla që kanë nevojë për mbrojtje ose për përmirësim, në mënyrë që të mbështesin jetën e peshqve OJ L264, 25. 09.2006, f .20.

Ky citim përfshin elementet e mëposhtme:

1. Formën (Direktivë)

2. Vitin e miratimit

3. Numrin e Direktivës

4. Baza në traktatin institucional (për shembull, KE, Euratom)

5. Emrin e institucionit/institucioneve përgjegjëse për miratimin e direktivës (p.sh. Komisioni, Këshilli, Parlamenti Europian dhe Këshilli)

6. Datën e miratimit

7. Numrin, datën dhe faqen e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Europian.

Vini re në veçanti rendin e vitit dhe numrin e aktit. Për aktet legjislative që nuk janë rregullore, viti i miratimit paraprin numrin e aktit.

Para vitit 1992, aktet kishin një numër unik. Tani është e mundur që një vendim, për shembull, të ketë të njëjtin numër me një direktivë, kështu që kontrollojini të gjitha detajet me kujdes.

Për shembull:

Direktiva e Komisionit 2000/23/EC, 27 prill 2000, me shtesa dhe ndryshime në Direktivën 92/76/EEC që njeh zonat e mbrojtura që janë të ekspozuara ndaj rreziqeve të veçanta të shëndetit të bimëve në BE,

dhe

2000/23/EC: Vendim i Këshillit, datë 6 dhjetor 1999, për përmirësimin e informacionit për aktivitetet legjislative të Këshillit dhe regjistrin publik të dokumenteve të Këshillit.

Para vitit 1999, data shprehej si një numër me dy shifra, por tani ka katër shifra.

4. SI TË GJEJMË NJË DIREKTIVË NË EUR-LEX

Mënyra më e lehtë për gjetjen e një direktive është nëpërmjet EUR-Lex-it. Zgjidhni Legjislacionin në Fuqi (Legislation in force) dhe më pas vazhdoni ose duke eksploruar këtë hapësirë në internet ose përmes kërkimit.

EKSPLORIMI

Duke përzgjedhur Adresarin e Legjislacionit në Fuqi të Bashkimit Europian (Directory of EU Legislation in Force) mund të gjeni direktiva, vendime dhe rregullore me anë të kërkimit nëpërmjet një teme (vetë faqes së Adresarit nuk mund t'i jepet një lidhje, pasi URL-ja ndryshon pas çdo versioni të ri të Adresarit).

Vini re se kjo është një listë vetëm për legjislacionin në fuqi – aktet e shfuqizuara nuk jepen në listë (për të gjetur elemente të tilla, shih më poshtë tek "Kërkimi").

Secili nga 20 seksionet kryesore të Adresarit ndahet më tej – po të klikoni mbi një titull do të shihni se cilat janë nënseksionet e tij. Në secilin seksion, materialet jepen në listë me rend kronologjik, ku i pari shfaqet materiali më i fundit në kohë.

Eksploroni seksionin përkatës derisa të identifikoni dokumentin që po kërkoni (nuk është gjithmonë e qartë se ku mund të gjendet një dokument i caktuar – ndonjëherë mund të jetë më i shpejtë përdorimi i opcionit të kërkimit).

Çdo material në listë ka një citim bazë, plus lidhjeve me tekstin e plotë (kur është e mundur, zgjidhni PDF, pasi do t'ju lejojë të shihni elemente grafike – përfshirë edhe tabela – të cilat në përgjithësi nuk përfshihen në versionin html). Ka lidhje për tekstet e tjera të lidhura me kërkimin, si për shembull shtesa dhe ndryshime dhe masa zbatuese.

Formatet

Secili nga materialet e gjetura është i disponueshëm në formate të ndryshme; në html, PDF dhe tiff (faksimile e cilësisë së latë, e ngjashme me PDF-në përsa i përket përfshirjes së grafikëve origjinalë; duke dhënë adresën tuaj të postës elektronike mund te merrni pa pagesë një skedar në tiff nga Zyra e Botimeve, në përgjithësi brenda 10 ose 15 minutash).

Çdo seksion i Adresarit është i disponueshëm dhe në PDF, që mund të përdoret për printim; lidhja e Arkivit (Archive) përmban versione të PDF-së të të gjitha 20 seksioneve për çdo muaj.

KËRKIMI

Në faqen e Legjislacionit në Fuqi (Legislation in force), kur përzgjedh opcionin e kërkimit (Search in legislation) hapet një kuti dialogu që ju lejon të jepni specifikime për llojin e legjislacionit që kërkoni (opcioni automatik është "All legislation") dhe për të përzgjedhur një numër opcionesh të tjera, si për shembull, duke përdorur fjalët kyçe (termat e kërkimit), duke kërkuar me datë ose periudhë kohore.

Vini re se opcioni automatik është kufizimi i kërkimit me aktet në fuqi – nëse doni të kërkoni legjislacion që nuk është më në fuqi, klikoni për të mos e përzgjedhur kutinë në të majtë, në fundtë faqes.

Pasi të keni bërë përzgjedhjen fillestare, klikoni butonin "Search". Nëse kërkoni me fjalë kyçe, kërkimi bëhet vetëm për titujt (ia vlen të lexoni "Udhëzimet e Shkurtra për Rezultate të Mira – Guidelines for Good Results" që jepen në faqen e "kushteve të kërkimit")

KËRKIMI SIPAS NUMRIT

Nëse e dini numrin e direktivës që po kërkoni:

- shkoni në EUR-Lex

- zgjidhni opcionin Simple search

- përzgjidhni Natural number, pastaj përzgjidhni "Direktivë" dhe shkruani vitin dhe numrin e direktivës dhe pastaj klikoni butonin "Search"

5. INFORMACION I MËTEJSHËM

Për më shumë informacion rreth procesit legjislativ dhe dokumentacionit të tij, shihni:

- Përmbledhjet e Legjislacionit: Direktiva

- Vendimmarrja në Bashkimin Europian (Decision-making in the European Union)

- Titujt nën "Direktivat" në Udhëzimin e Përbashkët Praktik A-Z

- ABC-ja e së Legjislacionit të BE-së (The ABC of EU law). (botim i vitit 2010; fq.88)

SI TË GJEJMË DOKUMENTET E KOMISIONIT

1. ÇFARË ËSHTË NJË DOKUMENT I KOMISIONIT

Dokumentet e Komisionit përbëjnë një prej kategorive më të mëdha dhe më të rëndësishme të dokumentacionit të Bashkimit Europian. Ato përbëjnë një përmbledhje të dokumenteve të punës të Komisionit Europian dhe, si të tilla, janë një burim i rëndësishëm informacioni për aktivitetet e një prej institucioneve kryesore të BE-së.

Si nismëtari zyrtar dhe mbikëqyrësi i zbatimit të legjislacionit të BE-së, Komisioni prodhon një sasi të konsiderueshme dokumentacioni, nga të cilat dokumentet e punës përbëjnë pjesën më të rëndësishme dhe më publike.

Jo të gjitha këto dokumente vendosen në dispozicion të publikut dhe mund të ketë boshllëqe në sekuencën numerike (kjo për shkak se disa numra u caktohen dokumenteve që nuk marrin miratimin e Komisionit dhe teksti i të cilave nuk publikohet asnjëherë).

2. LLOJET E DOKUMENTEVE TË KOMISIONIT

Dokumentet e Komisionit mund të ndahen në tri lloje kryesore:

a) Dokumente të konsultimeve të gjera për politikat

Zakonisht këto quhen "Komunikime", megjithëse përdoren edhe termat "Dokument i gjelbër" dhe "Dokument i bardhë". Këto dokumente janë raporte konsultative përpara nisjes së procesit legjislativ, ku përvijohen mendimet paraprake të Komisionit mbi një temë dhe kërkohen mendimet e palëve të interesuara si prelud i një veprimi formal të mundshëm legjislativ.

Për shembull, shih COM (2008) 725 final

Dokument i gjelbër: Për krahun europian të punës për shëndetësinë

Gjithnjë e më shumë, ky lloj dokumenti i Komisionit shoqërohet me një dokument të Sekretariatit të Përgjithshëm të Komisionit (dokument SEC), i cili përmban më shumë informacion, si të dhëna të hollësishme dhe vlerësime të efektit. Numri i dokumentit SEC shkruhet në faqen e titullit të dokumentit COM (për gjetjen e dokumenteve të Sekretariatit të Përgjithshëm, shih pikën 3 më poshtë).

b) Propozimet për legjislacion

Shumë dokumente COM të Komisionit marrin formën e propozimeve legjislative nga ana e Komisionit (përfshirë edhe shtesat dhe ndryshimet në këto propozime, të nxjerra pas konsultimit me institucionet e tjera të BE-së gjatë procesit të vendimmarrjes).

Ky lloj dokumentesh përfshin dy seksione të dallueshme nga njëri-tjetri:

- një "Relacion shpjegues", ku shpjegohet kontesti dhe qëllimi i propozimit dhe

- teksti i propozimit legjislativ.

Një shembull: COM (2008) 892 final -

Propozim për Vendim të Parlamentit Europian dhe Këshillit për ngritjen e një programi të bashkëpunimit audioviziv me profesionistët e vendeve të treta, të quajtur "MEDIA Mundus".

(vini re se faqja e parë e këtij dokumenti jep numrat e tri dokumenteve shoqëruese SEC).

c) Raporte për zbatimin e politikave

Ky lloj dokumenti i Komisionit analizon ose vlerëson zbatimin e ligjeve ose të politikave ekzistuese të Bashkimit Europian.

Një pjesë e mirë e legjislacionit të Bashkimit Europian i kërkon shprehimisht Komisionit të kryejë analiza të rregullta të zbatimit dhe efektit të legjislacionit në fjalë. Në raste të tjera, Komisionit mund t'ia kërkojë hartimin e një raporti të tillë Këshillit të Bashkimit Europian ose Parlamenti Europian.

Një shembull: COM (2008) 824 -

Raport i Komisionit drejtuar Këshillit dhe Parlamentit Europian, për përdorimin e lëndëve të tjera që nuk janë vitamina ose minerale në përbërësit shtesë ushqimorë.

Numri i dokumenteve COM të Komisionit të nxjerra çdo vit ndryshon, por për periudhën 2006-2008 kanë dalë mesatarisht 1482 dokumente në vit (690 propozime legjislative; 792 të tjera)

3. SI TË GJEJMË NJË DOKUMENT TË KOMISIONIT

Dokumentet COM publikohen tani në hapësirën në internet EUR-Lex, në rubrikën "Akte përgatitore". Qysh prej vitit 2000, mbulimi është i plotë, por mund të gjenden edhe shumica e teksteve të vitit 1999. Përdoruesit mund të eksplorojnë sipas vitit, muajit dhe ditës, dhe mund të bëjnë kërkime edhe sipas vitit dhe numrit të dokumentit.

(Nëse mundet, duhet të parapëlqeni gjithmonë versionin PDF të dokumentit, sepse kështu do të përfshini edhe figurat dhe tabelat, siç janë në tekstin origjinal).

Dokumentet COM të publikuara përpara vitit 1999 ndonjëherë mund të gjenden përmes Drejtorisë së Përgjithshme përkatëse të Komisionit. Një përmbledhje e vogël e dokumenteve më të rëndësishme të Komisionit publikohet në botim me letër të mirë me shkëlqim nga Drejtoria e Përgjithshme përkatëse, për të rritur ndërgjegjësimin e publikut.

Shikimi elektronik i dokumenteve jolegjislative të Komisionit të hartuara përpara vitit 1999 është më i vështirë, megjithëse ekziston një përmbledhje e dokumenteve të gjelbra dhe dokumenteve të bardha. Një burim alternativ në rritje është Arkiva e Integrimit Europian, e cila është një përmbledhje e dokumenteve të mëparshme të Komisionit.

Teksti i dokumenteve të mëparshme COM në formën e propozimeve legjislative mund të shihet përmes EUR-Lex-it në formate të tjera (domethënë, si propozim dhe pa relacionin shpjegues).

Disa prej dokumenteve të Komisionit të hartuara përpara vitit 1999, mund te merren në version të shtypur ose si mikrofilm. Citimi bibliografik i tyre mund të gjendet plotësisht në katalogët e shitjeve të quajtur "Dokumentet e Zyrës së Botimeve Zyrtare të Komuniteteve Europiane" (EUR-OP), të cilët dilnin deri në vitin 2000.

Dokumentet e mëparshme COM mund të gjenden në Qendrat Europiane të Dokumentacionit, zakonisht të vendosura në institucionet akademike, tani pjesë e rrjetit të drejtpërdrejtë europian.

4. SI TA CITOJMË NJË DOKUMENT TË KOMISIONIT

Dokumentet e Komisionit citohen me elementet kryesore të mëposhtme:

* COM

* (Viti)

* Numri i punës, final

* (data e miratimit nga Komisioni)

Shembull: Komunikim nga Komisioni. Europa dhe Azia: një kuadër strategjik për partneritetet e rritura, do të citohej si vijon:

COM (2001) 469 final, 4.9.2001.

Termi "final" shtohet në fazën kur Komisioni e miraton dokumentin dhe ai bëhet publik.

Vini re se dokumentet COM shpesh citohen pa fjalën "final" dhe se dalja në internet e tyre ka çuar në përdorimin e shenjës "/" në vend të shenjave "()", si për shembull COM/2008/0894 final, ku është përdorur edhe një zero në fillim të numrit të dokumentit.

Krahas kësaj, ato dokumente COM që janë propozime legjislative (kategoria e dytë e përshkruar më lart) kanë informacione shtesë që mund të jepen si pjesë e citimit. Kjo tregon një vit/numër pune dhe një kod me tri shkronja që bën të ditur procedurën legjislative që do të ndjekë propozimi, si:

COD (Bashkëvendim) SYN (Bashkëpunim) AVC (Pëlqim)

CNS (Konsultim).

Për shembull: *Propozim për Vendim të Parlamentit Europian dhe Këshillit për ngritjen e një programi të bashkëpunimit audioviziv me profesionistët e vendeve të treta, të quajtur "MEDIA Mundus",* citohet si vijon:

COM (2008) 892 final 2008/0258 (COD), ku tregohet se ky propozim do të ndjekë procedurën e vendimit të përbashkët.

SI TË GJEJMË JURISPRUDENCËN E GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EUROPIAN

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian (ose e njohur ndryshe si Gjykata e Drejtësisë) siguron "bën interpretimin e legjislacionit të BE-së duke garantuar që ai të zbatohet njëlloj në të gjitha shtetet anëtare të BE-së), (Neni 19, Traktati i Bashkimit Europian - TBE).

I njëjti nen thotë se Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian "përfshin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Përgjithshme dhe gjykatat e specializuara".

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga 27 gjyqtarë dhe tetë avokatë të përgjithshëm. Kur në regjistrin e Gjykatës shtohet një çështje, një nga avokatët e përgjithshëm jep një opinion të arsyetuar për pikat e legjislacionit me të cilat lidhet çështja. Vendimi përfundimtar jepet nga një trupë gjyqtarësh në një datë më të vonë. Kur disa çështje prekin të njëjtën pikë të legjislacionit, shpesh ato bashkohen në një seancë të vetme dhe njihen si "çështje të përbashkëta".

Gjykata e Përgjithshme (e quajtur më parë si Gjykata e Shkallës së Parë ose GJSHP) është krijuar në vitin 1989 nëpërmjet Aktit të Vetëm Europian për të përballuar ngarkesën në rritje të punës së GJED-së. Ajo merret me çështje që depozitohen nga zyrtarët e BE-se, rastet e konkurrencës dhe paditë për dëmshpërblime. Ajo merret gjithashtu me padi kundër institucioneve të BE-se dhe çështje të markave tregtare.

Tribunali i Shërbimit Civil të BE-së është krijuar në vitin 2004, ka shtatë gjyqtarë dhe merret me mosmarrëveshje që lidhen me nëpunësit e institucioneve të BE-së (çështje që më parë janë trajtuar nga GJSHP-ja dhe nga GJED-ja).

1. RAPORTET E GJYKATAVE EVROPIANE (ECR)

Raportet e çështjeve të ngritura para Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë (të cilat shpesh i përmendin si Raporte të Gjykatës Europiane ose si ECR-ja) janë tekstet zyrtare të opinioneve dhe vendimeve të GJED-së, GJSHP-së dhe të Tribunalit.

Për shkak të çështjeve të përkthimit, botimi i këtyre raporteve zyrtare mund të marrë deri në dy vjet pas daljes së aktgjykimit. Tekstet paraprake të opinioneve dhe vendimeve (ose "bocat") shpesh të shoqëruara me njoftime për shtyp, tani mund të gjenden dhe në hapësirën në internet të Gjykatës (Curia) ditën në të cilën dalin.

Në vitin 2009, hapësira në internet e GJDBE-së nisi të ofrojë shikimin e lehtë të çështjeve të fundit për secilën prej gjykatave:

Gjykata e Drejtësisë

Gjykata e Përgjithshme

Tribunali i Shërbimit Civil të BE-së

2. SI TË CITOJMË RAPORTET E GJYKATËS SË DREJTËSISË TË BASHKIMIT EUROPIAN

Çështja C-91/92 "Faccini Dori kundër Recreb" [1994] ECR I-3325

Ky citim përfshin elementet e mëposhtme:

1. Numrin e çështjes (C-91/92) që tregon se kur është shënuar çështja në regjistrin e Gjykatës (në vitin 1992 në këtë rast)
2. Emrin e palëve të përfshira (Faccini Dori kundër Recreb)
3. Vitin në të cilin është gjykuar çështja (1994)
4. ECR = Raportet e Gjykatës Europiane (seritë zyrtare të raporteve)
5. Seksioni I (nga 1989) = Gjykata e Drejtësisë (Seksioni II = Gjykata e Shkallës së Parë)
6. Numrin e faqes në të cilin fillon raporti.

Faqja është e njëjta për të gjitha versionet e gjuhëve të ndryshme të raporteve.

Deri në vitin 1993, secili raport përbëhej nga raporti i Seancës, Opinioni i Avokatit të Përgjithshëm dhe Aktgjykimi i Gjykatës. Nga viti 1994 botohen vetëm opinioni dhe aktgjykimi për të përshpejtuar procesin e përkthimit.

Çështjet nga GJSHP-ja citohen në të njëjtën mënyrë, me ndryshimin që numri i çështjes ka prefiksin T (Tribunal de Premiere Instance) dhe raporti del në Seksionin II, për shembull Çështja T-83/91 "Tetra Pak kundër Komisionit" [1994] ECR II-755.

Çështjet e Tribunalit kanë prefiksin F (Tribunal de la fonction publique).

Çështjet para vitit 1989 nuk kanë prefiks me shkronjë përpara. Ndërmjet vitit 1994 dhe krijimit të Tribunalit të Shërbimit Civil, çështjet e personelit nga GJSHP-ja trajtoheshin veçmas si **Raporte të Çështjeve të Personelit të Bashkimit Europian** (ECR-SC) dhe botoheshin vetëm ne gjuhën e seancës.

3. BURIMET E TJERA TË RAPORTEVE TË GJDBE-SË

Raportet e së Drejtës së Tregut të Përbashkët (CMLR) është një shërbim tregtar nga Sweet & Maxwell, që porosit përkthime të çështjeve të rëndësishme, në mënyrë që ato të jenë të disponueshme më shpejt. Që prej vitit 1998, kanë dalë dhe Suplementet Antitrust (Antitrust Supplements), që përmbajnë tekste të çështjeve të konkurrencës dhe të vendimeve të bashkimeve

4. INDEKSET

Çdo vit botohen dy indekse progresive nga GJED-ja; *Indeksi A-Z* që përmbledh të gjitha çështjet që prej vitit 1953 sipas emrit dhe numrit të çështjes dhe përfshin ato çështje që janë ende pezull (është i disponueshmë versioni online si shikim numerik i jurisprudencës - Numerical access to the case-law).

Shënimet - references des notes de doktrine, janë një indeks, sipas numrit të çështjes, ose neneve të çështjeve individuale në buletinet juridike (kjo gjendet ne faqen e internetit si shënime të vendimeve - Annotation of judgements).

Indekset gjenden dhe në pjesën përfundimtare të secilit prej Raporteve të Gjykatës Europiane dhe në secilin nga volumet e CMLR-së.

5. ÇËSHTJET E KOHËVE TË FUNDIT

Hapësira në internet e Gjykatës përfshin njoftimet për shtyp që kanë të bëjnë me aktgjykimet e reja; përmbledhje të detajeve të ndryshme botohen në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian.

Çështjet me rëndësi jepen në përgjithësi të formë të përmbledhur në buletinet ligjore dhe raportohen dhe nga entet e lajmeve të BE-së.

6. BURIMET ELEKTRONIKE

GJED-ja e hapi hapësirën e saj në internet, Curia, në vitin 1996, ku jep mundësi shikimi pa pagesë në të gjitha gjuhët e proceseve (që prej fundit të vitit 1996), opinioneve dhe aktgjykimeve të Gjykatës (që prej qershorit 1997) dhe njoftimeve për shtyp të kohëve të fundit.

Jurisprudenca e kohëve të fundit (d.m.th. që prej datës 17 qershor 1997) mund të kërkohet me emër pale, datë, numër çështjeje, fjalë ne tekst, dhe fushë (d.m.th. objekti).

Kjo hapësirë në internet përfshin disa baza të dobishme të dhënash: një përbledhje e jurisprudencës së Bashkimit Europian (vetëm ne frengjisht) ku përmblidhen vendimet sipas lëndës; një tabelë alfabetike të objektit (vetëm në frengjisht); Konventat dhe një version online vetëm në frengjisht të shënimeve të vendimeve.

Baza ligjore e të dhënave të BE-së, EUR-Lex (që ka zëvendësuar bazën e mëparshme të të dhënave Celex), përmban një rubrikë të jurisprudencës, që përmban aktgjykime, opinione, etj. Kjo rubrikë përfshin dhe një arkivë (që gjendet ne fund të faqes) e cila shkon deri në vitin 1954.

CD-ROM-et tregtare dhe versionet online të EUR-Lex-it mund t'i gjeni pranë: SAI Global (Eurolaw)

Justis Publishing (Justis Celex) Ellis Publications (OJ OnlinePlus).

Bazat e të dhënave ligjore LexisNexis Butterëorths dhe Ëestlaw përfshijnë të dyja mundësi shikimi të të gjitha dokumenteve ligjore të BE-së.

Vini re se EUR-Lex dhe Curia janë pa pagesë, por burimet tregtare (që ofrohen me pagesë) mund të jenë më të lehta për t'u përdorur.

7. GJETJA E NJË RAPORTI TË GJYKATËS

Çështjet që prej vitit 1954 gjenden në hapësirat në internet EUR-Lex dhe Curia, megjithëse të dyja ofrojnë opcione shumë të kufizuara kërkimi për shumicën e viteve.

Çështjet që prej qershorit 1997 mund të kërkohen ne Curia duke përdorur fjalë kyçe, emrin e palëve, etj.

Kërkimi i thjeshtë ne EUR-Lex për jurisprudencën jep mundësi shikimi të të gjitha çështjeve dhe lejon jo vetëm kërkim me fjalë kyçe, por dhe identifikimin e palëve (duke bërë kontrollin për një emër dhe duke e kufizuar kontrollin tek "Titulli"; në faqen e "kërkim i thjeshtë", zgjidhni "jurisprudenca", "kontrolloni termat").

Nëse e dini vitin dhe numrin e çështjes, përdorni listën e çështjeve në Curia, aksesin numerik ne jurisprudencë (Numerical access to the case-law) ose opcionin e EUR-Lex për kërkim me anë të numrit natyror.

SI TË GJEJMË MASAT ZBATUESE KOMBËTARE

Direktivat janë akte që duhet të zbatohen ne ligjet e shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

Sipas Nenit 288 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian TFEU:

Direktiva është e detyrueshme, në lidhje me rezultatin që duhet arritur, për çdo Shtet Anëtar të cilit i drejtohet, por ua lë autoriteteve kombëtare kompetencën e përzgjedhjes së formës dhe të mënyrave.

Ky udhëzim i shkurtër është përgatitur për të ndihmuar përdoruesit ta gjejnë legjislacionin përmes të cilit shtetet anëtare i zbatojnë këto Direktiva.

1. EUR-LEX

EUR-Lex, baza e plotë e të dhënave e BE-së për legjislacionin e Bashkimit Europian, jep lidhje me masat për zbatimin kombëtar të Direktivave pasi Komisioni Europian është njoftuar për to nga Shtetet Anëtare.

Masat kombëtare zbatuese jepen në "Shënimin Bibliografik", që shoqëron tekstin e Direktivës në disa versione, por jo në të gjitha.

Për të parë se si është "Shënim Bibliografik" shihni këtë shembull në EUR-Lex të Direktivës 75/439/EEC për largimin e mbetjeve të naftës.

Për t'u siguruar që ta shihni "Shënimin Bibliografik", gjejeni Direktivën duke kontrolluar në Adresarin e Legjislacionit të Bashkimit Europian ne fuqi (Directory of European Union legislation in force) dhe klikoni në numrin e dokumentit ("numrin Celex"), që është menjëherë sipër titullit të Direktivës, për shembull

31975L0439

Direktivë e Këshillit 75/439/EEC, datë 16 qershor 1975, për largimin e mbetjeve të naftës (OJ L 194, 25.7.1975, fq. 23–25)

Një mënyrë tjetër është, duke e gjetur Direktivën me anë të përdorimit të opcioneve të kërkimit në EUR-Lex "numri natyror" ose "Numri Celex", do të shihni opcionin e "Shënimit Bibliografik", siç jepet në këtë shembull.

Pasi ta keni gjetur "Njoftimin bibliografik" ecni poshtë deri sa të gjeni titullin "Trego masën kombëtare të zbatimit" ("Display the nacional execution measures"). Duke klikuar 'MNE' do të nxirrni në ekran një listë ligjesh kombëtare të miratuara për të bërë të zbatueshme Direktivën në disa ose ne të gjitha Shtetet Anëtare.

Jepen vetëm detajet bibliografike, dhe nuk ka lidhje për tekstet.

Vini re paralajmërimin "Përmendja e masave zbatuese kombëtare nuk do të thotë domosdoshmërisht se këto masa janë të plota ose në përputhje".

Ka disa probleme me këtë burim:

- Detajet e MNE-së janë të disponueshme vetëm ne "Shënimin Bibliografik" që shoqëron Direktivën; tekste të tjera HTML ose PDF të një Direktive nuk e përfshijnë këtë informacion; - MNE-ja jep titujt e dokumenteve, jo tekstet e tyre të plota;

- Informacioni i shfaqur është ai informacion që ia dërgon Komisionit autoriteti përkatës në secilin Shtet Anëtar; në varësi të shpejtësisë dhe të efikasitetit të këtij procesi, mund të ekzistojnë masa të cilat nuk janë të regjistruara ne EUR-Lex.

2. N-LEX

Mënyra më e mirë për të kontrolluar nëse është zbatuar një Direktivë është konsultimi me burimin kombëtar, edhe pse jo të gjithë pajtohen me këtë. Kjo tani mund të bëhet në një mënyrë gjerësisht të standardizuar për pjesën më të madhe të shteteve anëtare të BE-së nëpërmjet N-Lex.

I prezantuar nga Komisioni Europian në prill të vitit 2006 si shërbim eksperimental për zbatimin kombëtar, N-Lex lejon kërkimin në hapësirat ligjore zyrtare kombëtare në internet nëpërmjet një mënyre standarde dhe ofron mundësi për shikimin e tekstit të plotë.

Për çdo shtet anëtar për të cilin jepet informacioni (23 që prej prillit 2009), opcionet e disponueshme janë:

- kërkimi i burimit ose i burimeve legjislative zyrtare për atë vend,

- leximi i "informacionit të përgjithshëm" për to, procesin kombëtar legjislativ dhe llojet përkatëse të dokumenteve dhe opcionet e kërkimit që ofron N-Lex.

Për shkak të dallimeve midis strukturave të bazave kombëtare të të dhënave, jo të gjitha kërkimet funksionojnë për secilin Shtet Anëtar, por në përgjithësi është e mundur të kërkohet me anë të:

- fjalës kyçe

- numrit të dokumentit

- datës

Ofrohet ndihmë specifike sipas vendit, që i jep mundësi përdoruesit të identifikojë, për shembull, llojet e dokumenteve të disponueshme për një shtet anëtar të caktuar.

Mund të ndihmojë identifikimi i detajeve të dokumentit përkatës (p.sh. nëpërmjet Eur-Lex-it), para se të përdoret N-Lex-i.

4. VENDET QË KANË BËRË KËRKESË PËR ANËTARËSIM

Njësia e Ndihmës Teknike dhe e Shkëmbimit të Informacionit (TAIEX) e Drejtorisë së Përgjithshme për Zgjerimin pranë Komisionit ofron ndihmë të vlefshme për gjetjen e legjislacionit të BE-së, të zbatuar në vendet që kanë bërë kërkesë për t'u anëtarësuar në BE.

Nga hapësira në internet e TAIEX-it, zgjidhni "Bazat legjislative të të dhënave" ("Legislative Database"), më pas "Bazat e të dhënave për përafrimin e legjislacionit" ("LAD") dhe më pas përdorni ndihmën e kërkimit ("seach ëizard"). LAD-i ka aktualisht informacion për shtetet anëtare që u bënë pjesë e BE-së në vitin 2004 dhe 2007, si dhe për vendet kandidate dhe kandidate potenciale; në disa raste LAD-i ofron lidhje për tekstet e plota të legjislacionit.

5. MOTORËT E KËRKIMIT

Me kusht që informacioni të ekzistojë në internet, një mundësi tjetër e dobishme është përdorimi i motorëve të kërkimit. Kopjoni dhe shkruani numrin e referencës së direktivës, një tekst nga titulli (në gjuhën përkatëse) në Google ose në instrumentin tuaj të preferuar të kërkimit, dhe kështu duhet të gjenden masat zbatuese (të cilat duhet të bëjnë lidhjen me direktivën në origjinal).

Mund t'i ndryshoni lehtësisht gjuhët në EUR-Lex për të marrë titullin ekzakt në gjuhën që dëshironi.

Mund ta kufizoni kërkimin në Google për të nxjerrë një hapësirë të veçantë në internet duke përdorur "site"; dhe të gjithë ose një pjesë të URL-së (p.sh. site: ëëë.legilux.lu, site:gov.uk).

Për të gjetur adresa të hapësirave kombëtare legjislative në internet për shtetet anëtare të BE-së shkoni tek lista e faqes së internetit të Gjykatës së Drejtësisë. Disa prej tyre kanë motorë të mirë kërkimi, kështu që mund të kërkoni ne mënyrë të drejtpërdrejtë duke përdorur numrin ose tekstin e titullit të direktivës.

6. STATISTIKAT PËR ZBATIMIN

Faqja e Komisionit Europian rreth mënyrës së zbatimit të së drejtës së BE-së Application of EU Law jep informacion për zbatimin dhe shkeljet, ofron mundësinë për të parë raportet vjetore për zbatimin kombëtar të së drejtës së BE-së dhe për Tabelën për Zbatimin e së Drejtës së BE-së në nivel Kombëtar, e cila përmban opcione për të kërkuar me anë të vitit dhe numrit të direktivës, apo për të eksploruar përmbledhjet mujore (2009-2011) vetëm në frëngjisht, Duke parë skedarin për dhjetorin e vitit 2011, mund të shihni, për shembull, se data 31 e atij muaji është afati kohor për zbatimin kombëtar të Direktivës 2010/24/EU, që ka të bëjë me ndihmën e ndërsjellë për arkëtimin e kërkesave të lidhura me tatimet, taksat dhe masat e tjera.

SI TË SIGUROHET AKSESI DHE TË PËRDOREN REGJISTRAT E INSTITUCIONEVE

Konteksti
Neni 15, pika 2, e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Europian (TFEU) thotë:

Çdo qytetar i Bashkimit dhe çdo person fizik ose juridik që ka vendbanimin ose selinë e regjistruar në një shtet anëtar ka të drejtën të shohë dokumente të institucioneve, organeve, zyrave dhe agjencive të Bashkimit Europian, në çfarëdo forme të jenë këto dokumente...

Ky parim i përgjithshëm merr fuqi nga Rregullorja 1049/2001 (botuar në Fletoren Zyrtare L145, 31.05.2001).

Përkundër parimit që "të gjitha dokumentet e institucioneve duhet të jenë të shikueshme nga publiku", kjo rregullore parashikon një varg përjashtimesh, duke përfshirë edhe arsyet e sigurimit publik, mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës ekonomike.

Kjo rregullore parashikon dispozita të hollësishme, përfshirë edhe përkufizimin e "dokumentit" ("çdo përmbajtje pavarësisht formës, të lidhur me një çështje që ka të bëjë me politikat, aktivitetet dhe vendimet që bien në sferën e kompetencës së institucionit").

Në nenin 11 të saj, kërkohet që secili prej tre institucioneve duhet "t'i japë publikut liri që të shohë një regjistër të dokumenteve" dhe kjo "të bëhet në formë elektronike".

Në vitin 2001, këto tri institucione nxorën një deklaratë të përbashkët, kuu bënin thirrje organeve të tjera të BE-së që t'i japin mundësi publikut të shohë dokumentet e tyre, në përputhje me dispozitat e rregullores. Në vitin 2003, Komiteti Ekonomik dhe Social Europian (KES) dhe Komiteti i Rajoneve (KR) miratuan vendime me anë të të cilave krijonin regjistrat e tyre të dokumenteve.

SHIKIMI I REGJISTRAVE

Secili prej regjistrave ndodhet në kompjuterin qendror (serverin) e institucionit përkatës dhe ka adresën e vet URL, që jepet në rubrikën përkatëse më poshtë. Përndryshe, regjistrat mund të arrihen edhe përmes këtyre rrugëve:

1 – Në faqen kryesore të hapësirës në internet Europa, në rubrikën

"Botime dhe dokumente" (Publications and documents) zgjidhni "Dokumente zyrtare" (Official documents), pastaj përzgjidhni institucionin përkatës nga rubrika "Regjistri i dokumenteve" (Register of documents) (hë për hë, jo të gjitha institucionet ofrojnë regjistra).

2 – Në hapësirën në internet EUR-Lex, përdorni lidhjen në menynë në anën e majtë, "Hapësira e profesionistit" (Practitioner's Corner).

PARLAMENTI

Regjistri i Parlamentit Europian është më i gjeri nga tre regjistrat institucionalë. Ai jep lidhje dhe tekste që janë vendosur në hapësirën publike qysh prej datës 3 dhjetor 2001. Këto ndahen në katër grupe kryesore:

- dokumente që kanë të bëjnë me veprimtarinë parlamentare
- dokumente informative të përgjithshme për Parlamentin Europian
- dokumentet zyrtare të përcjella nga institucionet e tjera
- dokumente nga palë të treta

Regjistri ka mundësinë e njoftimit përmes postës elektronike për zërat e rinj, por nuk ofron mundësinë e eksplorimit të regjistrit, megjithëse mund të përdoret mundësia për të parëtë gjitha dokumentet gjatë një periudhe kohore të përzgjedhur.

Kërkimi i thjeshtë, që është edhe kërkimi automatik, është kërkim i titujve përmes fjalëve kyçe, por kërkimi i avancuar jep shumë mundësi të tjera, duke përfshirë mandatin parlamentar (i shtatë, i gjashtë ose i pestë), llojin e dokumentit (që mund ta shkruani vetë ose mund ta zgjidhni nga një meny e palosshme) dhe periudhën kohore. Ka edhe një shërbim të shkëlqyer ndihme.

Vini re se, edhe kur gjendet titulli i dokumentit, mund të mos ketë tekst online. Megjithatë, në këtë rast jepen këshilla si t'i merrni dokumentet.

KËSHILLI

Regjistri i Këshillit ka qenë regjistri i parë i cili u bë publik. Në të jepen titujt dhe, sa herë është e mundshme, tekstet e plota të dokumenteve të krijuara pas datës 1 janar 1999.

Ai përfshin dokumentet e mbledhjeve nga të gjitha konfigurimet e Këshillit, si edhe dokumentet në proces diskutimi nga institucionet e tjera, sidomos nga Komisioni.

Ndryshe nga hapësira në internet e Parlamentit, regjistri i Këshillit ofron mundësinë e eksplorimit të listës së zërave të shtuar dy javët e fundit (mundësitë "Latest documents references" dhe "Latest public documents (full text)").

Ofrohen mundësitë e kërkimit të thjeshtë dhe të kërkimit të avancuar, me ndihmë të bollshme online për formatimin e kërkimeve dhe këshilla të tjera shtesë "Si të kërkoni në regjistër". Të dyja mundësitë e kërkimit i japin mundësi përdoruesit të përzgjedhin nga një listë e objekteve.

Jo të gjitha dokumentet e renditura në listë jepen me tekst të plotë. Për shembull, duke përdorur nëntitullin AER (transporti ajror) për të gjetur dokumente të krijuara pas datës 1 janar 2007 (<1.01.2007) do të nxirrni një listë me më shumë se 70 zëra. Shënoni kutinë "Public documents" për të treguar vetëm ata zëra për të cilët mund të jepet teksti i plotë ose të cilët mund të jepen pjesërisht ose të cilët publikohen, por nuk janë në hapësirën në internet të Këshillit. Mundësia e gjetjes së dokumenteve të ndryshme ilustrohet përmes ikonave.

KOMISIONI

Regjistri i Komisionit përmban dokumente të publikuara qysh prej muajit janar 2001. Këto janë kryesisht, paçka se jo vetëm, dokumente përpara se të marrin formën legjislative, me numra COM, SEC ose C, plus dokumentet me rendin e ditës dhe me procesverbalet.

Ky regjistër ka një mjedis kërkimi, me mundësi për të kërkuar numrin ose datën e dokumentit, departamentin përgjegjës të Komisionit (përmes një menyje të palosshme), një ose disa fjalë në titull (maksimumi tre fjalë) dhe gjuhën e titullit. Mundësia e kërkimit sipas "objektit" nuk ofrohet më.

Njësoj si regjistri i Parlamentit, eksplorimi mund të bëhet duke përdorur kërkimin e dokumenteve brenda një periudhe kohore. Ka një mundësi ndihme, në menynë "informacion" në të majtë të faqes. (Regjistri mund të jetë i vlefshëm për të gjetur tekste të dokumenteve COM përpara se të botohen në rubrikën "Akte përgatitore" të EUR-Lex).

KOMITETET

Komitetet e ndihmojnë Komisionin të ushtrojë kompetencat e veta zbatuese. Ato përbëhen nga përfaqësues të Komisionit dhe të shteteve anëtare. Dokumentet e komiteteve i kalohen Parlamentit Europian. Vetëm dokumentet e përcjella gjenden në regjistër, duke përfshirë, për shembull, (projekt) rendin e ditës së mbledhjeve dhe përmbledhjet e mbledhjeve, projektlegjislacionin, përmbledhjet e rezultateve të votimit të komiteteve, dokumentet e punës.

Regjistri i komiteteve u prezantua për herë të parë në vitin 2004, por u ndryshua në prill 2008. Regjistri kryesor përmban dokumente qysh prej asaj date, ku materialet e mëparshme mund të gjenden në një arkivë.

Kjo hapësirë në internet jep informacione për sistemin e komiteteve dhe ka një listë të komiteteve ekzistuese. Një mjedis kërkimi në ekran ofron një sërë mundësish, ku si zgjedhje e parë është vendosur "Dossiers". Mundësitë shtesë të kërkimit mund të shihen duke përzgjedhur "Documents". Titulli, numri, data dhe Komiteti janë disa prej mundësive (vini re se nëse zgjidhni "Committee" hapet një dritare e re, nga e cila mund të bëhet përzgjedhja).

KES, KR

Regjistri i KES-it ofron mundësi kërkimi të thjeshtë dhe të avancuar, ku kërkimi mund të bëhet sipas fjalëve në tekst ose titull, llojit të dokumentit, autorit, datës. Në kërkimin e avancuar shtohen edhe mundësitë e numrit të dokumentit ose të dosjes.
Dokumenti i KR-së (Regjistri Elektronik i Dokumenteve) "i jep mundësi publikut të shohë të gjitha dokumentet që lidhen me procedurat konsultative dhe vendimmarrëse në fazat e ndryshme të nxjerrjes së tyre". Kërkimi mund të bëhet i thjeshtë, i avancuar dhe në formën "official letter".

INFORMACION I MËTEJSHËM

Titujt që japin regjistrat nuk kanë fuqi ligjore – vetëm tekstet e botuara në Fletoren Zyrtare njihen si versioni i vetëm origjinal.
Në një udhëzues të përbashkët përdorimi të Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit, për rregulloren, i cili është botuar në vitin 2002, u tërhiqet vëmendja përdoruesve të mos "ngatërrojnë lirinë për të parë dokumentet me lirinë e informimit" dhe se institucionet do të "japin dokumentet ekzistuese në formën në të cilën ndodhen", çka, duke pasur parasysh gjuhën zyrtare dhe/ose ligjore, do të thotë se jo gjithmonë janë të kuptueshme ashtu siç janë.
Komisioni nxjerr raporte vjetore për zbatimin e rregullores. Raportet më të fundit janë publikuar si më poshtë:
COM (2007) 841 (2006) COM (2008) 630 (2007) COM (2009) 331 (2008) COM (2010) 351 (2009)
Edhe Parlamenti Europian boton raporte për rregulloren, të cilat mund të gjenden përmes faqeve të regjistrit të tij, sikurse vepron edhe Këshilli, raportet e të cilit mund të gjenden përmes faqes së tij për politikën e lirisë për të parë dokumentet.
Në vitin 2007 u botua "Dokumenti i gjelbër për lirinë e publikut për të parë dokumentet që mbajnë institucionet e BAshkimit Europian: shqyrtim" (COM (2007) 185). Në vitin 2007 dhe në janar 2008 u zhvillua një konsultim publik, pas të cilit Komisioni nxori një raport për rezultatin e atij konsultimi SEC (2008) 29).
Në prill 2008, një projektrregullore "për lirinë e publikut për të parë dokumentet e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit" u botua me numrin COM (2008) 229. Ecuria e këtij propozimi mund të ndiqet përmes dosjes në PreLex.

SI TË MARRIM INFORMACION PËR FONDET E BE-SË

KONTEKSTI

Në këtë guidë jepet një informacion i përgjithshëm i fondeve që vendos në dispozicion BE-ja përmes financimit të programeve në fushat kryesore të politikave. Guida përqendrohet te informacioni për këto mundësi për të marrë fonde dhe nuk ofron këshilla si të bëhet kërkesë për fonde, megjithëse në disa prej hapësirave në internet që përmenden në të mund të gjeni ndihmë lidhur me këtë.

BUXHETI I BE-SË

Korniza financiare e BE-së për periudhën 2007-2013 mbulon:

- Rritjen e qëndrueshme (afro 50% të shpenzimeve; përfshin aftësinë konkurruese dhe kohezionin për rritjen dhe punësimin)
- Ruajtjen dhe administrimin e burimeve natyrore
- Qytetarinë, lirinë, sigurimin dhe drejtësinë
- Bashkimin Europian si aktor global
- Administratën (afro 5% e Buxhetit).

Në vitin 2008, Bashkimi Europian parashikoi në buxhet të shpenzonte 129 miliard euro, shumë e barabartë me 1.03% të të Ardhurave Kombëtare Bruto (PKB) të shteteve anëtare.

Komisioni Europian ofron informacion për programin financiar dhe buxhetin.

POLITIKA E PËRBASHKËT BUJQËSORE

Në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore, bujqësia vijon të marrë mbi 40% të mjeteve monetare të BE-së. PPB-ja është në proces reforme të vazhdueshme qysh në fillim të viteve 1990, ku ndryshimet përqendrohen kryesisht te rritja e aftësisë konkurruese të bujqësisë. Hapësira në internet e Komisionit "Zhvillimi bujqësor dhe rural" ofron informacion për gjendjen më të fundit të Politikës së Përbashkët Bujqësore.

KËRKIMI DHE ZHVILLIMI

Kërkimi dhe zhvillimi janë me rëndësi për objektivin e BE-së që ky të bëhet brenda vitit 2010 "ekonomia më konkurruese dhe më dinamike, e mbështetur në dije, në botë". Një element qendror i Strategjisë së Lisbonës, e cila synon arritjen e këtij objektivi, është krijimi i një Zone Kërkimore Europiane (ZKE). Informacion të hollësishëm për përpjekjen e BE-së për ta rritur shpenzimin për kërkimin dhe zhvillimin deri në 3% të PBB-së (synim kryesor) mund të gjeni në hapësirën në internet Investing in European Research.

Programet kornizë janë instrumenti kryesor i BE-së për financimin e punës kërkimore. Programi i shtatë kornizë për punën kërkimore dhe zhvillimin teknologjik 2007-2013 (FP7) ka një buxhet gjithsej prej 50.5 miliard euro për 7 vjet, së bashku me buxhetin për kërkimin bërthamor prej 2.7 miliard euro.

Objektivat e gjerë të programi të shtatë kornizë janë grupuar në katër kategori: Bashkëpunimi, idetë, njerëzit dhe kapacitetet. Me një buxhet prej 32 miliard euro, bashkëpunimi mbulon tema të tilla si shëndetësia, energjetika, hapësira, nanoshkencat, mjedisi dhe teknologjitë e informacionit dhe të komunikimit (TIK). Informacion të hollësishëm gjeni në hapësirën në internet CORDIS FP7.

FONDET STRUKTURORE

Mbështetja për rajonet më të varfra ka qenë prioritet i politikave të BE-së për shumë vjet dhe ka katër fonde të ngritura mirë për ta vënë në jetë politikën e saj rajonale:

- Fondi Europian për Zhvillim Rajonal (FEZHR) i cili synon promovimin e kohezionit ekonomik dhe social përmes zvogëlimit të pabarazive midis rajoneve;

- Fondi Social Europian (FSE) i cili përqendrohet në objektivat strategjikë të politikës së punësimit të BE-së;

- Fondi Europian i Garancisë për Bujqësinë (FEGB) i cili financon si pagesat e drejtpërdrejta për fermerët, ashtu edhe masat për rregullimin e tregjeve bujqësore; Fondi Bujqësor Europian për Zhvillimin Rural (FBEZHR) i cili financon programet e zhvillimit në fshat. Për më shumë informacion shihni "Mundësitë e financimit në kuadër të Politikës së Përbashkët Bujqësore";

- Fondi Europian i Peshkimit (FEP) synon si mbrojtjen e burimeve dhe të mjedisit detar ashtu edhe sigurimin e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonave peshkatare. Më shumë informacion mund të merrni përmes hapësirës në internet të FEP-së.

Gjatë periudhës programore 2007-2013, BE-ja do të investojë 308 miliard euro (me çmimet e vitit 2004) për programacionin e rritjes rajonale dhe për nxitjen e krijimit të vendeve të punës. Mbi 81% do të përqendrohet tek objektivi i konvergimit, duke mbuluar shtetet anëtare dhe rajonet më të varfra. Në rajone të tjera, rreth 16% e fondeve strukturore do të përqendrohet te mbështetja për novacionin, zhvillimin e qëndrueshëm, mundësi më të mira arritje dhe projekte trajnimi në kuadër të objektivit të rritjes së aftësisë konkurruese rajonale dhe punësimit.

2.5% të tjera do të jenë në dispozicion të bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkombëtar dhe ndërrajonal nnë kuadër të objektivit për bashkëpunimin territorial europian.

Për më shumë informacion shihni Politikën Rajonale – objektivat kryesorë.

EDUKIMI DHE TRAJNIMI

Programi i Mësimit Gjatë Gjithë Jetës është kryeprogrami financues i BE-së në fushën e arsimit dhe trajnimit. Për periudhën 2007-2013, buxheti prej 7 miliard euro i këtij programi do të mbështesë projekte dhe aktivitete që nxisin shkëmbimin, bashkëpunimin dhe lëvizshmërinë midis sistemeve arsimore dhe trajnuese, në bazë të shtyllave të mëposhtme:

- Comenius: nevojat për mësimdhënie dhe mësimmarrje të të gjithë personave që ndodhen në arsimin parashkollor dhe shkollor deri në fund të arsimit të mesëm.

- Erasmus: nevojat për mësimdhënie dhe mësimmarrje të të gjithë personave në arsimin e lartë, duke përfshirë edhe praktikën e studentëve pranë firmave në vende të tjera.

- Leonardo da Vinci: nevojat për mësimdhënie dhe mësimmarrje të të gjithë personave në arsimin dhe trajnimin profesional, duke përfshirë edhe praktikën e personave jo studentë pranë firmave.

- Grundtvig: nevojat për mësimdhënie dhe mësimmarrje të personave në të gjitha format e arsimit dhe edukimit të popullsisë së rritur.

GRANTET

Të gjitha drejtoritë e përgjithshme të Komisionit kanë kompetenca për dhënien e granteve. Granti "është një kontribut financiar i drejtpërdrejtë i Komisionit Europian për të mbështetur një aksion ose projekt të veçantë me natyrë jotregtare, për mbulimin e kostove që i plotësojnë kushtet dhe që u lindin drejtpërdrejt përfituesve".

Grantet mund t'u jepen organizatave të ndryshme, duke përfshirë universitetet, firmat, grupet e interesit dhe organizatat joqeveritare. Informacione të hollësishme për shumë mundësi financimi, përfshirë edhe grantet, mund të merren përmes faqes së Komisionit Contracts and grants.

Organe të tilla si Zyra e Varieteve të Bimëve e BE-se dhe Agjencia Europiane e Barnave japin grante brenda fushave të tyre të politikave – shih faqen "Grants and Public Contracts".

PËRFITUESIT

Komisioni jep tani informacion të hollësishëm për përfituesit e fondeve të BE-së (Beneficiaries of EU funds), përfshirë ata që marrin fonde të BE-së përmes administratorëve kombëtarë.

SI TË MARRIM INFORMACION PËR KONTRATAT DHE TENDERAT E BE-SË

BLERJET PUBLIKE NË EUROPË

Çdo vit, organizatat e sektorit publik në Europë blejnë mallra dhe shërbime me vlerë rreth 1500 miliard euro.

Për të pasur siguri që ky treg funksionon në mënyrë të hapur dhe të drejtë, janë miratuar një varg direktivash europiane, ku përcaktohen procedurat që duhet të ndjekin blerësit kur blejnë materiale, shërbime dhe punime (domethënë, ndërtime).

Direktivat kërkojnë që kontratat mbi një vlerë të caktuar duhet të shpallen në të gjithë BE-në në Suplementin e Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian (OJS). Ato përcaktojnë edhe gjëra të tilla si afatet minimale për proceset e tenderave, standardet teknike që duhet të përcaktohen në dokumentacionin e tenderit dhe kriteret mbi të cilat duhen vlerësuar ofertat.

Legjislacioni i BE-së mbulon një gamë të gjerë organizatash, duke përfshirë organet e pushtetit qendror dhe vendor, spitalet dhe shkollat publike dhe ato organizata që ofrojnë shërbime publike të tilla si ujësjellës-kanalizime dhe energjetikë.

Tekstet e direktivave dhe dokumenteve të tjera mund t'i gjeni përmes faqeve të Komisionit për Legjislacionin mbi Prokurimin Publik.

PRAGJET

Pragjet rishikohen çdo dy vjet. Për orientim, duke filluar nga muaji janar 2010, vlerat (pa TVSH) të përcaktuara në Rregulloren 1177/2009 janë: Materialet – 125 000 euro (193,000 euro për disa autoritete) Shërbimet - 125,000 euro (193 000 euro për disa shërbime) Punimet – 4 845 000 euro

Kontratat që janë poshtë pragjeve të përcaktuara në direktiva, nuk duhet të shpallen në OJS, por duhet të jepen, sidoqoftë, sipas kushteve të rregullave europiane për konkurrencën e ndershme.

LLOJET E NJOFTIMEVE

Njoftimet e shpallura në OJS përfshijnë:

Njoftimet parainformuese (domethënë, informacioni periodik) : Njoftim paraprak për një synim për realizimin e një tenderi për materiale, shërbime ose punime.

Ftesat për tender: këto nxirren për katër lloje kryesore procedurash:

- "të hapura", ku çdo shoqëri tregtare mund të dorëzojë një ofertë

- "të kufizuara", ku shoqëritë tregtare dorëzojnë informacion fillestar dhe pastaj zgjidhen vetëm disa prej tyre për të dorëzuar ofertë të plotë

- "dialog konkurrues", ku shoqëritë tregtare dorëzojnë informacion fillestar dhe pastaj një grup i përzgjedhur i firmave punojnë me organin publik për t'i përcaktuar kërkesat në mënyrë më precize përpara organizimit të tenderit

- "negocim", ku autoriteti kontraktues negocion drejtpërdrejt me një ose disa prej firmave (përdoret vetëm në rrethana të posaçme)

Njoftimet për fitimin e kontratës, shpalljet e publikuara për përfundimin e procesit të tenderit, që mund të japin (por jo gjithmonë) hollësi për ofertën fituese dhe për vlerën e kontratës.

GJETJA E TENDERAVE TË BE-SË

Suplementi i Fletores Zyrtare të Bashkimit Europian: OJS gjendet në dy formate: Format elektronik si baza e të dhënave "Tenders Electronic Daily" (TED) dhe në formë CD-ROM.

Tenders Electronic Daily: Kjo mund të gjendet në internet në adresën ted.europa.eu, TED përditësohet pesë herë në javë dhe mund të gjendet në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së. Pas përzgjedhjes së gjuhës, është e mundur të shikohen njoftimet për datën e edicionit përkatës ose të kërkohet e gjithë baza e të dhënave.

Mundësitë e kërkimit që ofrohen përfshijnë "Standard", "I zgjeruar" dhe "Specialist". Forma e kërkimit të zgjeruar, për shembull, lejon kërkimin me kriteret e ndryshme, duke përfshirë vendin, kodin e industrisë (duke përdorur Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve, CPV), emrin e autoritetit kontraktues, afatin dhe tekst të lirë.

Është gjithashtu e mundur të kërkohet arkiva e bazës së të dhënave, e cila përmban rreth pesë vjet shpallje, por për këtë do t'ju duhet të regjistroheni (regjistrimi është falas).

RITRANSMETIMI I INFORMACIONIT

Rrjeti i qendrave zyrtare të ritransmentimit të informacionit të BE-së (Enterprise Europe Netëork, EEN), i cili në muajin shkurt 2008 zëvendësoi rrjetin "Euro Info Centre". Anëtarët e EEN-së mund të ofrojnë shërbime njoftimi për bizneset e interesuara për të identifikuar mundësitë për kontrata. Një listë të anëtarëve të Enterprise Europe Netëork dhe informacion të hollësishëm për shërbimet e tyre e gjeni në hapësirën në internet të EEN.

Edhe Qendrat Europiane të Dokumentacionit, të cilat tani janë pjesë e rrjetit Europe Direct, mund të japin këshilla. Këto qendra mund t'i gjeni përmes faqes EDC të Komisionit.

Një sërë shoqërish tregtare ofrojnë shërbime me abonim, shpesh të mbështetura te OJS-ja. Këto shërbime marrin formën e botimeve të shtypura dhe/ose hapësirave në internet dhe zakonisht mund të gjenden përmes internetit.

TENDERAT NËN PRAG:

Autoritetet publike nuk janë të detyruara të botojnë shpallje në OJS për kontratat që bien poshtë pragjeve të caktuara në direktiva (megjithëse, kjo nuk u ndalohet). Për rrjedhojë, nuk ka një burim për gjetjen e mundësive të tilla për kontrata: informacioni publikohet në një shumëllojshmëri vendesh, duke përfshirë shtypin lokal dhe rajonal, revistat tregtare, hapësirat në internet të organizatave, etj.

INFORMACION I MËTEJSHËM

BE-ja ka një hapësirë në internet SIMAP që u kushtohet prokurimeve publike, ku jepet informacion shtesë, duke përfshirë direktivat përkatëse të BE-së, Fjalorin e Përbashkët të Prokurimeve që përdoret për të kategorizuar ftesat për tender, pragjet e vlerave të kontratave, etj.

Informacione të hollësishme të mëtejshme për politikën e BE-së për prokurimet publike gjenden edhe në hapësirën në internet Europa, ku faqet për prokurimin publik japin informacion shpjegues dhe lidhje për shumë prej burimeve të përmendura në këtë guidë, dhe një rubrikë për tenderat dhe kontratat e BE-së ka lidhje për "Njoftimet për tender nga institucionet e BE-së".

Doing business ëith the European Commission: Tips (Si të bëni biznes me Komisionin Europian: këshilla praktike për sipërmarrësit e ardhshëm) është një broshurë me 16 faqe që flet për një gamë çështjesh të lidhura me prokurimet, duke përfshirë edhe si të gjejmë informacion për mundësitë për të fituar kontrata, procedurat e prokurimit dhe të tenderimit.

Edhe ministritë e vendeve të ndryshme zakonisht kanë informacione të ndryshme lidhur me masat për të zbatuar direktivat e BE-së, në hapësirat e tyre në internet. SIMAP përfshin një listë bazash kombëtare të dhënash për prokurimin publik.

PROGRAMET EUROPIANE TË FINANCIMIT

Programet e zbatuara me fondet e Bashkimit Europian administrohen nga Komisioni Europian, zakonisht nga drejtoria e përgjithshme përkatëse.

Thirrjet për tendera ose për shprehje interesi shpallen në serinë C të Fletores Zyrtare (Informacion dhe Njoftime – që arrihet përmes faqes të OJ EUR-Lex) dhe në hapësirat në internet të drejtorive të përgjithshme, megjithëse Komisioni përdor gjithnjë e më shumë agjencitë ekzekutive për administrimin e këtyre programeve. Agjencitë e ngritura deri tani përfshijnë:

- Agjencia Ekzekutive për Arsimin, Audiovizionin dhe Kulturën (EACEA)

- Agjencia Ekzekutive e Këshillit Europian të Kërkimit (ERC)

- Agjencia Ekzekutive për Aftësinë Konkurruese dhe Novacionin (EACI - programet e energjisë dhe sipërmarrjes)

- Agjencia Ekzekutive për Shëndetësinë dhe Konsumatorët (EAHC)

- Agjencia Ekzekutive e Kërkimit (REA)

- Agjencia Ekzekutive e Rrjetit Ndëreuropian të Transportit (TEN-T EA)

SI TË GJEJMË STATISTIKAT E BE-SË

1. HYRJE

Shumica e statistikave të BE-së mblidhen dhe publikohen nga Eurostati, Zyra Statistikore e Bashkimit Europian, që është organ në nivel drejtorie të përgjithshme pranë Komisionit Europian. Detyra e saj është t'i sigurojë BE-së statistika në nivel europian, çka mundëson krahasimet midis vendeve dhe rajoneve në kuadër të hartimit dhe zbatimit të politikës së Bashkimit Europian.

2. TË DHËNAT

Organet statistikore të shteteve anëtare mbledhin të dhëna, të cilat verifikohen dhe analizohen dhe i dërgohen Eurostatit (nëse të dhënat nuk dërgohen, nuk pasqyrohen në tabelat e Eurostatit).

Vetë Eurostati zakonisht nuk mbledh të dhëna, por i konsolidon të dhënat dhe kujdeset që të jenë të krahasueshme, duke përdorur metodikë të harmonizuar (lexoni metodikën e një grupi të dhënash për të zbuluar se çfarë do të thotë kjo).

Ky proces do të thotë se të dhënat më të fundit të publikuara mund të mos jenë shumë të kohëve të fundit, por siguron realizimin e krahasimeve që kanë kuptim. Të dhënat e mbledhura nga shtetet anëtare dhe vendet kandidate dhe publikohen në nivel të vendit, të zonës së monedhës euro dhe të BE-së. Në disa raste, përfshihen krahasime me ekonomi të tjera madhore.

Mbulimi i temave është i gjerë, por disa fusha janë më të pasura me të dhëna se të tjerat (për shembull, bujqësia mbulohet me më shumë hollësi, për shkak të vëmendjes tradicionale që i ka kushtuar BE-ja kësaj fushe).

Eurostati përdor të njëjtin klasifikim tematik për të gjitha produktet dhe bazat e të dhënave, me nëntë tema kryesore dhe 30 "nëntema", ku temat kryesore janë:

- Statistika të përgjithshme dhe rajonale
- Ekonomia dhe financa
- Popullsia dhe kushtet shoqërore
- Industria, tregtia dhe shërbimet
- Bujqësia dhe peshkimi
- Tregtia e jashtme
- Transporti
- Mjedisi dhe energjia
- Shkenca dhe teknika

3. SI TË ZBULONI SE ÇFARË NXJERR EUROSTATI

Të dhënat që nxjerr Eurostati jepen në botimet të shtypura, në CD ROM-e dhe në baza të dhënash. Të gjitha botimet e Eurostatit, prej vitit 2003, mund të shkarkohen falas nga hapësira e tij në internet.

Eurostati nuk e nxjerr më katalogun vjetor të botimeve, por në vend të tij nxjerr informacione periodike për produktet dhe shërbimet e veta, të cilat mund t'i shihni online përmes rubrikës Botime (Publications) në hapësirën e tij në internet.

Udhëzuesi më i plotë dhe më aktual për produktet e Eurostatit është hapësira në internet, e cila ka një mjedis kërkimi, si edhe lejon eksplorimin sipas temave.

4. ÇFARË GJENDET NË HAPËSIRËN NË INTERNET?

Hapësira në internet ofron statistika pa pagesë, plus informacion shpjegues për Eurostatin dhe informacione të hollësishme për produktet, metodikën dhe klasifikimin.

Mes materialeve kryesore që gjenden me tekst të plotë nga mjedisi kryesor në ekran (i cili është riprojektuar në vitin 2009) janë:

Vjetari i Eurostatit,

Njoftime për shtyp

Statistika në fokus / Të dhënat në fokus (botime për tema të caktuara, zakonisht 4-12 faqe; "Statistics in focus" ofron më shumë shpjegime se seria e re "Data in focus"; vini re se lista nuk bën dallim midis këtyre dy serive).

Lidhja për bazën e të dhënave statistikore (nga ana e majtë lart faqes kryesore) paraqet një pamje në formë peme të të dhënave të disponueshme. Zgjerimi i një rubrike çon në një listë kapitujsh për të cilët ka të dhëna. Në të majtë të çdo kapitulli ka një ikonë për shërbimin e Eurostatit "Tabela, grafikë dhe harta".

Në të djathtë të secilit titull ndodhet një ikonë për "Tekste shpjeguese (metadata)". Nëse e klikoni, hapet një dritare dialogu që jep informacion për të dhënat në fjalë, siç janë burimi dhe monedha.

Nëse klikoni "Tabela, grafikë dhe harta", hapet një dritare e re, me alternativa për të parë të dhënat e paraqitura në këto tre formate (zgjedhja e parë është "Tabela"; nëse klikoni tabularin përkatës në të majtë lart faqes, dhe nëse sistemi funksionon, të dhënat paraqiten sipas formës së kërkuar).

Vizitorët mund të regjistrohen pranë kësaj hapësire në internet për të parë alternativa të tjera shtesë për të dhënat (për shembull, një pemë të përshtatur) dhe për të marrë njoftime përmes postës elektronike lidhur me botimet e reja.

5. BURIME TË TJERA TË STATISTIKAVE TË BE-SË

Botimet e shtypura të Eurostatit i mbajnë një sërë bibliotekash. Idealja do të ishte që përdoruesit ta identifikojnë produktin ose botimin e nevojshëm nga hapësira në internet, përpara se të kontaktojnë bibliotekën e tyre ose qendrën e informacionit europian (për një listë të këtyre, vizitoni hapësirën në internet Europe Direct).

Shumë institucione dhe agjenci të BE-së botojnë statistika dhe materiale të tilla si dokumentet COM mund të jenë burime të vlefshme statistikore (shihni udhëzuesin "Si të gjejmë dokumentet e Komisionit"). Përdorni rubrikën Policy areas në hapësirën në internet Europa për të gjetur lidhje sipas temave.

Statistikat për BE-në dhe shtetet anëtare botohen nga një varg organizatash, ku përfshihen:

OECD

Banka Botërore

Organizata e Kombeve të Bashkuara (Dega Statistikore e Komisionit Ekonomik të OKB-së për Europën (UNECE) ka një listë organizatash të statistikave në rajonin e UNECE-së).

Të dhënat e Eurostatit u shiten dhe botuesve tregtarë / furnizuesve të të dhënave për t'i përdorur në produktet e tyre (për shembull, në Vjetarin Statistikor që boton Data Service & Information).

6. SUGJERIME PËR GJETJEN E STATISTIKAVE TË BE-SË

Përcaktoni temën, mbulimin gjeografik (për shembull: BE, zona e monedhës euro, vendi), serinë kohore dhe formatin (material i shtypur/elektronik) të statistikave që ju duhen.

Paketat e të dhënave elektronike

Kontrolloni bazat e të dhënave

- që gjenden lirisht në internet

- të cilat mund t'i arrini përmes bibliotekës suaj

- të cilat mund të arrihen në biblioteka të tjera të rajonit tuaj.

Formë e shtypur/PDF

- kontrolloni vjetarin e Eurostat-it (Eurostat Yearbook) (ku jepen burime dhe lidhje të tjera për të ndihmuar në gjetjen e më shumë informacioni)

- kontrolloni hapësirën në internet të Eurostat-it duke përdorur temën (theme) ose fjalën kyçe (keyword) për të identifikuar botimin që ju duhet.

Çfarë të bëni nëse ...

1. Të dhënat nuk gjenden

- kontaktoni një pikë shitjeje të dhënash për të mësuar si mund të gjenden të dhënat.

2. Të dhënat nuk janë aktuale sa duhet

- në hapësirën në internet të Eurostat-it kontrolloni rubrikat "Njoftime për shtyp" (News releases) dhe "Statistika në fokus/të dhëna në fokus" (Statistics in focus / Data in focus) ose provoni diku tjetër (shihni "Burime të tjera" përkundruall).

3. Ju duhen më shumë të dhëna për një vend të caktuar

- provoni të shikoni OFFSTATS ose hapësirën në internet të njërës prej zyrave statistikore kombëtare.

4. Botimi nuk gjendet aty ku ndodheni

- provoni të shkoni në një qendër të dokumentacionit europian, në një bibliotekë kryesore, të kërkoni marrje materialesh hua midis bibliotekave ose ta blini botimin pranë një pike shitjeje.

5. Ju duhet më shumë ndihmë

- vizitoni faqen User support të Eurostat-it për një shërbim ndihme pa pagesë përmes postës elektronike në çdo shtet anëtar.

SI TË MBLEDHIM INFORMACION KËRKIMOR PËR BE-NË (UDHËZUES PËR STUDENTË)

1. KATALOGËT E BIBLIOTEKAVE

Për të gjetur punë kërkimore dhe dokumente të shtypura, fillojeni kërkimin tuaj me katalogun e bibliotekës së universitetit apo shkollës ku mësoni. Gjithmonë e më shumë universitete kanë filluar të kenë një kënd të dokumentacionit europian dhe mund t'ju ofrojnë mundësi për të parë botime të ndryshme mbi Bashkimin Europian.

Jashtë koleksioneve të specializuara, biblioteka të veçanta ka shumë të ngjarë të mbajnë vetëm një sasi të vogël të buletineve ose librave që ju duhen, por mund të merrni tituj të tjerë përmes huave përmes bibliotekave ose shërbimeve elektronike.

Katalogun e Bibliotekës së Komisionit Europian- ECLAS mund ta gjeni online . Ai është një prej vendeve më të mira ku mund të gjeni citimin bibliografik të librave, artikujve dhe dokumenteve zyrtare që lidhen me Bashkimin Europian. Edhe botimet online katagolizohen dhe mund të kërkohen më vete.

Një indeks i hollësishëm i librave dhe i artikujve të botuar për të drejtën e BE-së nxirret çdo vit nga Biblioteka e Gjykatës së Drejtësisë me titull "Bibliografia juridike e integrimit europian" (shihni faqen e Librarisë së BE-së EU Bookshop).

Buletini "European Access" është botuar nga viti 1980 deri në vitin 2002. Në të përfshiheshin artikuj, përmbledhje legjislacioni dhe bibliografi të hollësishme të librave dhe artikujve në gjuhën angleze. Këtë buletin mund ta gjeni në formë elektronike në hapësirën në internet "Burimet Europiane Online" European Sources Online.

2. EUROPA

Hapësira në internet e Komisionit Europian "Europa" ka një sasi shumë të madhe informacioni për Bashkimin Europian, duke përfshirë historinë, institucionet, politikat dhe legjislacionin e tij.

Faqja kryesore e Europa ka gjashtë meny kryesore.

1 – Për BE-në

Rubrikat e kësaj menyje përfshijnë:

Informacion bazë

Institucionet dhe organet

Historia

Terminologjia

2 – Politikat dhe aktivitetet

Fushat e poltikave

3 – Jeta juaj në BE

Kujdesi shëndetësor

Të drejtat e konsumatorëve

4 – Merrni pjesë!

Konsultimet me publikun

Blogje

Video

5 – Botime dhe dokumente

Dokumente zyrtare

Legjislacioni dhe traktatet

Publikime

Statistika dhe sondazhe

Arkiva

6 – Qendra mediatike

Shërbimet e shtypit

Video dhe foto

Një mundësi me lidhje të shpejta (Quick links) ka meny që synojnë grupe të tilla:

Biznesi

OJQ

Shkollat dhe universitetet

3. KËRKIMI SIPAS TEMAVE

Hapësira në internet e Komisionit Europian "Përmbledhje të Legjislacionit të BE-së (ndryshe e njohur edhe si SCADPlus) ofron shpjegime të kuptueshme për shumicën e fushave të politikave, legjislacione të rëndësishme dhe procesin legjislativ.

Seria e dokumenteve Fact Sheets e Parlamentit Europian është një seri tekstesh prezantuese, zakonisht me informacione të mira historike, megjithëse me theks te roli i Parlamentit. Rubrikat kryesore janë:

Si funksionon Bashkimi Europian

Europa e Qytetarëve

Politikat e përbashkëta të Tregut të Brendshëm

Bashkimi ekonomik dhe monetar

Marrëdhëniet e jashtme të BE-së

Komisioni Europian nxjerr një gamë të gjerë raportesh vjetore, të cilat mund të ofrojnë një pikënisje të mirë për ndjekjen e hartimit të politikave të veçanta.

Krahas Raportit të Përgjithshëm për Aktivitetet e Bashkimit Europian (në internet prej vitit 1997) dhe raporteve të veçanta për politikën e konkurrencës dhe për bujqësinë, shumë raporte dalin si dokumente të Komisionit dhe botohen në rubrikën "Akte përgatitore" të EUR-Lex-it.

Megjithëse disa burime në internet mund të shfrytëzohen vetëm përmes pajtimit, janë hapur shumë hapësira në internet nga institucione zyrtare dhe akademike, për të vendosur në dispozicion të lirë të publikut materialet kërkimore. Një prej hapësirave më të vlefshme është arkiva europiane e dokumenteve kërkimore European Research Papers Archive, me qendër në Vjenë, një pikë shikimi e kërkueshme me 13 seri materialesh akademike.

Arkiva e integrimit europian Archive of European Integration e cila përfshin versione në format PDF të dokumenteve zyrtare të cilat nuk gjenden gjetkë. Prej vitit 2008, ofrohet një shërbim i dërgimit të dokumenteve përmes Arkivës, ndërsa në vitin 2009, stafi i Arkivës së Integrimit Europian filloi të shtojë fjalimet e zyrtarëve të Komunitetit nga viti 1975-1984.

Për punën kërkimore aktuale, përdorni Përmbajtjen Aktuale të Integrimit Europian, e cila ka listën e përmbajtjes të rreth 110 buletineve nga 14 vende dhe përfshin edhe disa abstrakte.

4. NDËRGJEGJËSIMI AKTUAL

Njoftimet për shtyp nga BE-ja i gjeni në rubrikën Press Room të Europa-s. Një mbulim të mirë të punëve të BE-së në shtypin anglisht mund ta gjeni në buletinin javor European Voice si edhe në Financial Times.

Për një pamje më të gjerë, mund të shihni euobserver, i cili ka reportazhe të lidhura me BE-në nga e gjithë bota, si edhe EurActiv, i cili ofron analizë të mbështetur në informacion dhe shpjegime për një gamë të gjerë problemesh të BE-së. Lajmet me interes të veçantë për komunitetin e biznesit janë në qendër të vëmendjes së EUbusiness.

5. LEGJISLACIONI

Tekstet e traktateve, marrëveshjeve ndërkombëtare, legjislacionit, akteve përgatitore, jurisprudencës dhe pyetjeve parlamentare mund t'i gjeni lirisht online në EUR-Lex.

Tekstet e aktgjykimeve dhe opinioneve të Gjykatës së Drejtësisë prej vitit 1997 gjenden në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së në hapësirën në internet të Gjykatës së Drejtësisë, Curia.

Krahas kërkimit "shikim i shpejtë" në faqen kryesore, kërkimi i avancuar ju mundëson alternativa të tjera, përfshirë edhe kërkimin me fjalë kyçe. Nëse doni të eksploroni sipas numrit të çështjes, këtë mund ta bëni duke përdorur mundësinë "Shikim numerik" (Numerical access).

Gjykata e Drejtësisë nxjerr një bibliografi të çështjeve që janë përmbledhur në buletinet juridike si "Shënime të aktgjykimeve" (Annotation of judgments).

Mos e ngatërroni Gjykatën e Drejtësisë me Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është institucion i Këshillit të Europës dhe jo i Bashkimit Europian

6. EUROPE DIRECT

Komisioni ka ngritur rrjetin Europe Direct për t'iu përgjigjur pyetjeve për BE-në. Pyetjet mund të bëhen përmes telefonit, postës elektrnike ose personalisht (shihni hapësirën në internet për adresat).

7. CITIMET DHE BIBLIOGRAFITË

Gjithmonë shënoni titullin e artikujve, librave, raporteve, etj., nëse i përdorni, sidomos kur bëni fotokopje, duke qenë se mund të jetë shumë e vështirë t'i identifikoni më vonë. Nëse jeni duke shkruar një disertarcion, duhet të shënoni titullin bibliografik në fund të faqes. Bibliografitë duhet të paraqesin autorin, titullin, botuesin dhe datën e botimit të librave, në rastin e artikujve të buletineve duhet të jepni edhe titullin, vëllimin, numrin e pjesës dhe numrin e faqeve të buletinit.

Kur përmendni një artikull ose raport të botuar online, është mirë të shkarkoni ose shtypni një kopje, duke qenë se materialet në internet mund të lëvizen ose madje të zhduken fare.

"E drejta e Bashkimit Europian: udhëzues i integruar për kërkimin e materialit elektronik dhe të shtypur", me autore Marilyn J. Raisch, jep shembuj citimesh për dokumentet zyrtare.

SI TË QËNDROJMË TË PËRDITËSUAR PËR BE-NË

BE-ja është një organizëm dinamik, i cili zhvillohet vazhdimisht në përgjigje të kërkesave të brendshme dhe të jashtme. Përkufizimi i fjalës "përditësuar" nuk është i lehtë: disa njerëz duan t'i ndjekin zhvillimet ditë për ditë, disa të tjerë mund të kënaqen me një informim vjetor. Burimet e përmendura këtu mund t'i mbulojnë të gjitha nevojat.

